

VENDIM
Nr. 267, datë 10.5.2006

PËR CAKTIMIN E EKSPTERTËVE FINANCIARË NË SHOQËRITË
HUAMARRËSE, NË ADMINISTRIM

(Ndryshuar me VKM nr. 569, datë 23.8.2006)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 1 të ligjit nr. 8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8360, datë 10.6.1998 “Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr. 8279, datë 23.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr. 9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e 5 ekspertëve financiarë, sipas listës që i bashkëngjitet këtij vendimi, për kontrollin financiar të shoqërive huamarrëse dhe për të kontrolluar nxjerrjen e koeficientit të kthimit të shumave kreditorëve, të shoqërive huamarrëse, në administrim.

2. Shoqëritë huamarrëse, në administrim, dhe institucionet e tjera, që kanë pasur marrëdhënie me to, të vënë në dispozicion të ekspertëve financiarë dokumentacionin e nevojshëm, sipas dispozitave në fuqi.

3. Përcaktimi i numrit të ekspertëve financiarë për secilën shoqëri huamarrëse, në administrim, të bëhet nga Grupi Mbikëqyrës, sipas vëllimit të punës

4. Ekspertët financiarë të punojnë për një periudhë kohe prej 6 muajsh dhe të shpërblehen, secili me 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë në muaj.

5. Efektet financiare, prej 2 400 000 (dy milionë e katërqind mijë) lekësh, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

6. Ngarkohen Grupi Mbikëqyrës dhe administratorët e shoqërive huamarrëse, në administrim, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA EMËRORE E EKSPTERTËVE FINANCIARË TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE

1. <i>Sabri Palamani</i>	4. Vebi Musliu
2. Armand Shini	5. Veis Alizoti
3. Arian Saliasi	